REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i zhvillimit urban, planifikimit të territorit dhe infrastrukturës

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve nr.54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67, datë 30.04.2025 " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Komisioni i zhvillimit urban, planifikimit të territorit dhe infrastrukturës, i mbledhur me datën 29 Prill 2025, shqyrtoi projekt vendimet nr.54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67 datë 28.02.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për " Miratimin e korrigjimit të gabimeve materiale" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni hartoi relacionin:

Bashkia sipas parashikimeve ligjore të kësaj VKM nr.329 datë 22.05.2019 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjensinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi" është organi që ngarkohet për plotësimin e mangësive të dokumentacionit ose sipas rastit vijon me trajtimin e kërkesave.
Në listat emërore të Këshillit Bashkiak janë vërejtur gabime materiale.

Në këto projektvendime u vu re se qytetarët kanë depozituar kërkesën pranë Zyrës së Shërbimit me qytetarët, me anë të cilës kanë kërkuar korigjimin e emrit, mbiemrit apo atësisë, rast pas rasti.

Bazuar në ligjin nr 44/2015 "Kodi i Proceurave adminidtrative", neni 112.
Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ

1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.
2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.

Nga shqyrtimii këtyre projektakteve, rezulton se kërkesat janë të plota dhe qytetarët kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar

Për sa parashtruam më lartë, komisioni,

VENDOSI

T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

kalimin e projektakteve nr. 54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67datë 30.04.2025 " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale". në Mbledhjen e Këshillit të datës 30.04.2025 për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim,

____Dritan Peçi_____ Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

_____Denisa Islamaj____ Anëtar

(emri, mbiemri, firma)

___Enea Vasili_____ Anëtar

(emri, mbiemri, firma)